



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 263, Datë 31.08.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“AYEN ENERGY TRADING” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2044/1 prot., datë 30.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës Nr. 229, Seria T14/T19, të shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN ENERGY TRADING” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2044 prot., datë 21.08.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës Nr. 229, Seria T14/T19, është 15.03.2024).
- Shoqëria paraqiti aplikimin për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit më datë 21.08.2023, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar; aplikanti duhet të depozitohet në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas

Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “AYEN ENERGY TRADING” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit si vijon:
 - **Neni 16, pika 5 dhe 7:** Në zbatim të kushteve të licencës dhe të kërkesave të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të shlyejë ndaj ERE-s pagesat e rregullimit.
- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 16.03.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijani, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI